



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura IV

Sesioni vjeshtor

Komisioni për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale

Mbledhja nr. 82

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-10

Prishtinë, më 19 nëntor 2013, në orën 10:00

P R O C E S V E R B A L
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR SHËNDETËSI, PUNË
DHE MIRËQENIE SOCIALE

Në mbledhje morën pjesë: Fikrim Damka, Time Kadrijaj, Flora Brovina, Salihe Mustafa, Gëzim Kelmendi, Bahri Thaçi dhe Nazane Breca.

Munguan: Liburn Aliu dhe Sasha Gjokiq.

Të pranishëm: Shaip Muja - deputet, Shpresa Haxhijaj - koordinatorë e Komisionit, Xheneta Sopjani - praktikante.

Mbledhjen e kryesoi, Fikrim Damka, kryetar i Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky

Rend dite:

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 28.10.2013;**
- 3. Shqyrtimi i Projektligjit për produkte medicinale dhe pajisje medicinale;**
- 4. Të ndryshme.**

Kryesuesi konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen me shqyrtimin e pikës së parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës
Rendi i ditës u miratua pa asnjë ndryshim.

2. Miratimi i procesverbalit të mbajtur më 28.10.2013

Komisioni miratoi pa vërejtje procesverbalin e mbledhjes së mbajtur më 28.10.2013.

3. Shqyrtimi i Projektligjit për produkte medicinale dhe pajisje medicinale

Fikrim Damak- Tha se ne e kemi përfunduar amendamentimin e projektligjit, sot do t'i shqyrtojmë amendamentet e deputetit Shaip Muja, dhe do ta procedojmë projektligjin në komisionet e tjera.

Shaip Muja- Tha se gjatë periudhës së amendamentimit në muajin qershor, kam kërkuar që në këtë projektligj të përfshihet edhe çështja e medikamenteve bujqësore. Arsyeja pse po kërkoj që në këtë projektligj të shtohen edhe medikamentet bujqësore është se kjo çështje është e rregulluar njëjtë në shumë shtetet evropiane. Problemi është se si në Kosovë po futen në treg këto produkte pa asnjë kriter dhe kontroll, dhe ne si ligjvënës po angazhohemi në ngritjen e cilësisë së medikamenteve medicinale, kurse komponentin tjetër shumë të rëndësishme të shëndetit të njeriut nuk po e kontrollojmë. Unë e kam shtruar këtë çështje edhe në Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, dhe kam kërkuar që të krijojë infrastrukturën e duhur ligjore, sa i përket kësaj çështje. Propozoj që në Nenin 1, pas fjalës “njerëzor” të shtohet “veterinar dhe bujqësor”. Gjithashtu të ndryshohet edhe titulli i projektligjit, në mënyrë që të mos krijojmë hapësirë për keqpërdorime, sepse kohëve të fundit kam dëgjuar që në Kosovë kanë futur produkte në emër të barnatoreve bujqësore dhe janë përdorë për qëllime humane dhe krejt kjo në mungesë të infrastrukturës ligjore.

Flora Brovina- Tha se kjo që po kërkon deputeti Muja është shumë me vend, por duhet më shumë kohë dhe analizë.

Bahri Thaqi- Tha se gjatë punës në këtë ligj e kemi parë që shumë gjëra të cilat i kemi futur në këtë projektligj as AKPPM, e as MSH nuk mund t'i realizojë kështu siç janë për shkak të mungesës së kapaciteteve. Mendoj që kjo çështje duhet të iniciohet, qoftë në Ministrinë e Shëndetësisë, ose në Ministrinë e Bujqësisë., Mirëpo duhet patjetër të jetë ligj i veçantë, sepse është e pamundur të inkorporohet pjesa që propozon deputeti Muja, e të mos bëhen ndryshime të mëdha në këtë projektligj.

Time Kadrijaj- Tha se përkundër qëllimit të mirë të deputetit Muja, mendoj që është shumë vonë për një ndërhyrje të tillë, më mirë të bëhet një ligj i veçantë.

Salihe Morina- Tha se jemi vonuar për ta futur tash këtë pjesë që po e propozon Shaip Muja, dhe me duket i pamundur realizimi i saj, tashti, në këtë fazë, ndonëse e shoh shumë të nevojshme.

Gëzim Kelmendi- Tha se ne kemi dy agjenci të cilat veprojnë të ndara, njëri për produkte medicinale, tjetri për veterinarë dhe ushqim. Prandaj nëse produktet e veterinarëve i fusim te produktet për përdorim njerëzor, atëherë krijojmë përzierje të kompetencave të këtyre agjencive. Këto janë agjenci të ndara dhe duhet të veprojnë si të ndara. Ne as në Ligjin për krijimin e Odave të Mjekëve nuk i kemi futur Odat e Veterinareve me gjithë kërkesën e tyre.

Nazane Breca- Tha se pajtohem me qëllimin e mirë dhe nevojën e krijimit të një ligji të tillë për kontrollin e produkteve medicinave- veterinare, por kjo të bëhet me ligj të veçantë.

Shaip Muja- Tha se nuk po kërkoj me larguar inspektoratin e bujqësisë, thjesht po kërkoj me standardizuar sipas ligjeve të Republikës së Kosovës, me ligj, se si duhet me qenë medikamenti i përgatitur për shtazët. Nëse ma besoni, unë e punoj këtë pjesë bashkë me stafin, dhe e diskutojmë në javën e ardhshme. Nëse ne fillojmë me ju adaptuar paaftësisë së administratës së AKPPM-së, atëherë nuk kemi bërë asgjë. E rëndësishme është që të nxjerrim një ligj të mirë, dhe jo ta përshejtojmë nxjerrjen e çfarëdo ligji.

Kjo është praktikë evropiane, të cilën e adaptojnë shumë shtete, kështu e kanë të rregulluar Serbia dhe Kroacia.

Gëzim Kelmendi- Tha se kjo është një problematikë ndryshe. Ne po provojmë me i futë me një ligj sektorin human dhe blegtoral, ndërkohë që ne i kemi të ndara edhe ministrinë, edhe agjencitë. Ne nuk kemi asnjë shembull në Kosovë që dy ministrinë e kanë për bazë një ligj.

Fikrim Damka- Tha se ne duhet të konsultohemi me AKPPM-në dhe me Agjencinë e Ushqimit dhe Veterinarisë, Ministrinë e Shëndetësisë dhe me Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural.

Gëzim Kelmendi- Tha se duhet ta shohim në rajon ose ne vendet e BE-se, se cilat vende e kanë një sistem të tillë dhe ta shohim se si funksionon, a e kanë të përbashkët një agjenci ose të ndarë?

Shaip Muja- Tha se nëse ne e aplikojmë këtë, nuk ndryshojmë asgjë në funksionim të monitorimit dhe të inspektimit, përkundrazi po e ngritim nivelin e përgjegjshmërisë për ata që bëjnë biznes në këtë fushë, duke e rritur kualitetin dhe kontrollin e shërbimeve. Licenca merret njëjtë, si për barna humane edhe për ato veterinare, dhe kontrolli është i njëjtë në laboratorin e kontrollit të ilaçeve. Pjesa veterinare i kthehet Ministrisë së Bujqësisë dhe i marrin në përdorim për shërbimin doganorë dhe për inspektimin e distribuimit, sepse edhe ruajtja e ilaçit duhet të bëhet njëjtë si për njeriun, ashtu edhe për shtazët. Bërja e dy ligjeve është vetëm humbje kohe.

Fikrim Damka- Tha se fillimisht duhet të konsultohemi me Ministrinë e Shëndetësisë, si sponzoruese e ligjit, e pastaj me Ministrinë e Bujqësisë. Nuk besoj se me dy ose tre nene mund ta rregullojmë këtë çështje.

Shaip Muja- Tha se kjo që po propozoj unë, nuk ndryshon asgjë në strukturën administrative, nuk shtohet asnjë punonjës, nuk gjeneron asnjë problem ekonomik. Secila firmë që dëshiron ta regjistroj medikamentet i paguan vetë shpenzimet në laboratorin e ilaçeve, ai laborator është dashur që prej krejt këtyre regjistrimeve ta mbajë vetën. Andaj, ju lus, edhe një herë të bisedojmë edhe t'i shohim disa shtete si e kanë të rregulluar këtë çështje.

Fikrim Damka- Tha se do ta caktojmë një grup i cili do të merret me bisedime me dy ministritë dhe agjencitë, dhe të nxjerrim konkluzionet e duhura, pastaj të marrim një vendim.

3. Të ndryshme

Kërkesa e kompanisë “ PRIMA PHARM “ u vendosë të shqyrtohet mbledhjen e ardhshme.

E përgatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

Kryetari i Komisionit

Fikrim Damka